



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
KOMISIONI I APELIMIT

Nr. 1526 Prot.

Elbasan, më 10.06.2024

VENDIM

Nr. 2, Datë 10.06.2024

"PËR

**HARTIMIN DHE APROVIMIN E RREGULLAVE PËR
MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TE APELIMIT"**

Në zbatim të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve, për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" (neni 37), Vendimit të Senatit Akademik Nr.32, datë 17.05.2024 "Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit të Apelimit në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" (shkresa nr.1231/2 Protokollit datë 17.05.2024) si dhe Vendimit Nr.35, datë 07.06.2024 "Për disa ndryshime në Vendimin e Senatit Akademik Nr.32, datë 17.05.2024" "Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit të Apelimit në Universitetin e Elbasanit" "Aleksandër Xhuvani", Komisioni i Apelimit, i konstituar me Vendimin Nr.1 datë 10.06.2024 në mbledhjen e datës 10.06.2024, të filluar në orën 09:00, e vazhdon këtë mbledhje pas marrjes së Vendimit Nr.1.

Anëtari i Komisionit, njëkohësisht dhe kryetari i tij, parashtron për vendimarrje, për të përfshirë në rendin e ditës të mbledhjes aktuale të këtij Komisioni Apeli edhe çështjen e hartimit dhe aprovimit të rregullave për mënyrën e funksionimit të Komisionit te Apelimit, që përbën një detyrim ligjor të menjëhershëm për tu përmbushur pas konstituimit te Komisionit të Apelimit dhe zgjedhjes së kryetarit dhe sekretarit.

Anëtarët e Komisionit të Apelimit, pasi u njohën me këtë kërkesë dhe konsultuan pikën 6 të Nenit 37 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve, për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, vendosën me unanimitet: shtimin në rendin e ditës edhe të pikës së kërkuar lidhur me hartimin dhe vendosjen e rregullave për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Apelimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Në vijim, propozohen rregullat për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Apelimit, si më poshtë vijon:

1. Komisioni i Apelimit shqyrton dhe merr vendim të arsyetuar bazuar në ligjmëri dhe në prova, në formën e kërkuar nga ligji.
2. Komisioni i Apelimit shqyrton çdo ankim që drejtohet kundër vendimeve të marra nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ).
3. Vendimi i Komisionit të Apelimit është i formës së prerë, përfundimtar, i detyrueshëm për t’u zbatuar.
4. Komisioni i Apelimit njofton me vendimarrjen e tij palën që ka paraqitur ankimin nëpërmjet publikimit në ambientet e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe në faqen zyrtare elektronike të këtij universiteti, në garanci të parimit të transparencës.
5. Komisioni i Apelimit garanton parimin e qeversjes së mirë, transparencës dhe integritetin.
6. Komisioni i Apelimit vepron në përputhje me normativën ligjore në fuqi.
7. Komisioni i Apelimit vendos të zbatojë deklaratën e konfidencialitetit për anëtarët e tij, sipas modelit që do t’i bashkëlidhet vendimit përkatës.
8. Vendimet e Komisionit të Apelimit janë të ankimueshme në rrugë gjyqësore nga pala që ka interes të ligjshëm.
9. Vendimet e Komisionit të Apelimit për të qenë të vlefshme duhet të jenë të aprovuara me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të tij.

Sa më sipër Komisioni i Apelimit aprovon me unanimitet rregullat për mënyrën e funksionimit të tij.

Në përfundim, të gjithë anëtarët shprehen se nuk kanë argumenta të tjera për të shtuar në këtë mbledhje dhe vendosin me unanimitet mbylljen e kësaj mbledhje në orën 10:10, datë 10.06.2024.

Ftohen të gjithë anëtarët të nënshkruajnë vendimin dhe procesverbalin e mbledhjes së mbajtur sot dhe njoftohen për mbledhjen e rradhës që kushtëzohet nga situatat apo çështjet që mund të bëhen me dije nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve.

Kryetari i Komisionit të Apelimit
Prof.as.Dr. Rezarta Tahiraj

Sekretar i Komisionit të Apelimit
Ph.D. cand Armelda Teta

Anëtar
Dr. Zyhra Gripshi

Anëtar
Dr. Ardita Dylgjeri

Anëtar
Dr. Mimoza Shkëmbi